



**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahim, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna Suharekë, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.831-1/17 të dt 23.05.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par par 1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.07.06.2017 solli:

### AKT GJYKIM

**APROVOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.831-1/17 të dt 23.05.2017 dhe gjykata jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Suharekë, i lindur me datë, [REDACTED], nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 11.05.2017 rrethë orës 14:30, në pyllin-vendin e quajtur "Paralelja e 60" rajoni ekonomiko-pyJOR "Neredime-Jezerc", me të cilin qeveris Drejtoria për Bujqësi, PylItari-Sektori i PylItaris Ferizaj, i pandehuri me qëllim për të vjedhur, ka prerë 4 copë trungje, të llojit ahu, me dimensione të gjatë boniteti III, me diametër 22-43 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.50 metra kub, me çrast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 349.38 Euro,-

- me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton.

## DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës; Drejtoria për Bujqësi, Pylltari-Sektor i Pylltaris Ferizaj, t'ja kompenzoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 349.38 Euro në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.831-1/17 të dt 23.05.2017 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], komuna Suharekë, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par par 1 të KPK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Gjyakta duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës procesverbalin dhe fletëparaqitjen e rojës së pyllit dhe vlerësimin dhe llogarinë e dëmit të shkaktuar, nëp 226/2017 i dt 16.05.2017 i DBP- Ferizaj, gjykata e shpall fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së që të dëmtuares: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari-Sektor i Pylltaris Ferizaj, t'ja kompenzoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 349.38 Euro në afat prej 15 dite pas plotfuqishmerisë të këtij aktgjykimi..

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.1297/2017 i dt.07.06.2017**

**Zyrtare Ligjore**

Lavdiye Brahim

**Gjyqtari**

Adem Shabani



#### **UDHËZIM JURIDIK:**

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.